



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 29, datë 02.04.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “HOTEL 1, 2, 3
DHE 4 KATE MBI TOKË, ME 2 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN E BARRIKADAVE, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues Z.Mentor Petrela, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Hotel 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë, me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën e Barrikadave, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Z. Mentor Petrela.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Vendimi Nr. 23, datë 03.10.2018 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi 1, 3 dhe 4 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën e Barrikadave, Bashkia Tiranë”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LNËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/04 / 2025